



BULETIN MUJOR

DHJETOR 2025



PËRMBAJTJA

- Finalizohet Maratona Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2025
- Zhvillohet tryezë ndërinstucionale mbi forcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijëve online
- AKSK zhvillon webinar mbi rreziqet kibernetike dhe mbrojtjen onlinenetik
- Menaxhimi i incidenteve kibernetike në fokus të takimit me operatorët e infrastrukturave kritike
- Projektet e AKSK për vitin 2026 në fokus të takimit me partnerët ndërkombëtarë
- Masat e sigurisë kibernetike gjatë festave, në fokus të takimeve koordinuese me infrastrukturën

Finalizohet Maratona Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2025



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike përmbylli me sukses Maratonën Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2025, një nismë inovative dhe gjithëpërfshirëse që bashkoi 500 studentë, nxënës të shkollave profesionale, vajza e gra, si dhe persona me nevojë të veçanta, duke krijuar hapësirë reale për zhvillimin dhe vlerësimin e aftësive në sigurinë kibernetike.

Përmes kësaj maratone, u krijua gjithashtu një platformë konkrete për identifikimin dhe promovimin e talenteve të reja, si një hap i domosdoshëm drejt ndërtimit të kapaciteteve kombëtare në këtë fushë. Ky fokus përputhet me drejtimin strategjik të Shqipërisë, e cila sot renditet ndër vendet me zhvillim të avancuar në aspektin e sigurisë kibernetike në nivel ndërkombëtar dhe synon të forcojë më tej këtë pozicion.

Në përmbyllje të aktivitetit, u ndanë çmime për fituesit në secilën kategori, duke vlerësuar arritjet dhe performancën e tyre.



Zhvillohet tryezë ndërinstucionale mbi forcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijëve online

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, zhvilloi një tryezë ndërinstucionale mbi mbrojtjen e fëmijëve në hapësirën digjitale, me fokus rreziqet në rritje online dhe nevojën për përf forcimin e kuadrit ligjor dhe mekanizmave të mbrojtjes. Diskutimet u përqendruan te format e reja të abuzimit digjital dhe sfidat që paraqet realiteti aktual për mbrojtjen efektive të fëmijëve.

Gjatë tryezës u theksua domosdoshmëria e rishikimit dhe përshtatjes së dispozitave ligjore ekzistuese, si dhe rëndësia e edukimit digjital dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, shkollës dhe prindërve. Institucionet pjesëmarrëse identifikuan hapat konkretë për ndërhyrje, në funksion të zbatimit të masave që synojnë rritjen e sigurisë dhe mirëqenies së fëmijëve në hapësirën online.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039



AKSK zhvillon webinar mbi rreziqet kibernetike dhe mbrojtjen online

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi gjatë muajit dhjetor një webinar informues të drejtuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Igli Tafa, me fokus rreziqet kibernetike të shtuara gjatë periudhës së festave dhe nevojën për rritjen e vigjilencës në hapësirën digjitale. Webinarin u ndoq online nga një audiencë e gjerë dhe shërbeu si një platformë ndërgjegjësimi për qytetarët dhe institucionet publike.

Gjatë webinarit u trajtuan skenarë konkretë të mashtremeve online, mbrojtja e të dhënave personale dhe rëndësia e praktikave të sigurta digjitale. Aktiviteti është pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të AKSK për informimin publik dhe forcimin e kulturës së sigurisë kibernetike në vend.

Menaxhimi i incidenteve kibernetike në fokus të takimit me operatorët e infrastrukturave kritike

AKSK në bashkëpunim me DCAF, zhvilloi takimin e katërt me operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, duke përmbyllur ciklin e parë të punës për rritjen e kapaciteteve kombëtare në sigurinë kibernetike. Takimi u fokusua në menaxhimin e incidenteve dhe krizës kibernetike, si një element kyç për garantimin e vijimësisë së shërbimeve dhe mbrojtjen e sistemeve digjitale.

Gjatë aktivitetit u prezantua procesi i menaxhimit të incidenteve, duke përfshirë fazat e zbulimit, kategorizimit, analizës dhe koordinimit me AKSK, si dhe menaxhimin e ndikimit në shërbimet për qytetarët. Pjesëmarrësit ndoqën një demonstrim praktik të një incidenti real, i cili ilustroi nevojën për procedura të qarta, reagim të koordinuar dhe komunikim institucional në raste krize kibernetike.



Projektet e AKSK për vitin 2026 në fokus të takimit me partnerët ndërkombëtarë

AKSK zhvilloi një tryezë diskutimi me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me qëllim prezantimin e projekteve strategjike dhe diskutimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë kibernetike. Takimi u fokusua në prioritetet institucionale dhe në koordinimin e veprimeve për adresimin e sfidave aktuale dhe të ardhshme në hapësirën digjitale.

Gjatë diskutimeve u prezantuan drejtimet kryesore të projekteve për vitin 2026, të cilat përfshijnë forcimin e mbrojtjes së infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore, si dhe rritjen e mbrojtjes online për qytetarët, veçanërisht fëmijët dhe të rinjtë. Partnerët dhe donatorët u angazhuan në shkëmbimin e ideve dhe në identifikimin e mundësive konkrete për mbështetjen e këtyre objektivave, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2025–2030.



Masat e sigurisë kibernetike gjatë festave, në fokus të takimeve koordinuese me infrastrukturën

AKSK zhvilloi një seri takimesh koordinuese me përfaqësues të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, me fokus rritjen e gatishmërisë dhe forcimin e koordinimit përballë rreziqeve kibernetike gjatë periudhës së festave të fundvitit. Diskutimet u përqendruan në kontekstin e rritjes së aktiviteteve online dhe ekspozimit më të lartë ndaj kërcënimeve në këtë periudhë.

Gjatë takimeve u trajtuan masa konkrete për monitorim të shtuar të sistemeve, reagim të shpejtë ndaj incidenteve dhe shkëmbim efektiv informacioni në kohë reale, si dhe rëndësia e ndërgjegjësimit të stafit dhe rritjes së gatishmërisë operacionale. Paralelisht, u diskutuan edhe drejtimet kryesore të planifikimit për vitin në vijim, me fokus forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e qëndrueshmërisë kibernetike në nivel kombëtar.

